UNIVERSITETI - UNIVERSITY
"ISA BOLETINI"
MITROVICË
Fakulteti i Teknologjisë Ushqimore

Modeli i Programit mësimor të lëndës (Syllabusi)		
Fakulteti:	Fakulteti Teknologjisë Ushqimore	
Departamenti:	Departamenti i Teknologjisë	
Niveli:	Master	
Kodi i lëndës:	409.IMM.II	
Lënda:	Trajtimi i Ajrit të Ndotur	
Statusi i lëndës:		Obligative
Semestri:		Dimëror
Fondi i orëve:	2+2	Sipas programit të aprovuar
ECTS:	6	Sipas programit të aprovuar
Orari/Salla	9:00 -10:30 / 107	
Viti akademik:	Viti i I-rë, semestri i II-të	
Mësimdhënës/e:	Prof. Asoc. Dr. Flora Ferati	
Asistent/e:		
Kontaktet:	Mësimdhënës/e	Asistent/e
Email:	flora.ferati@umib.net	
Telefon:	+ 383 (0) 44 383 803	

PERMBAJTJE	Modulet kryesore të kursit Trajtimi i ajrit të ndotur janë: ➢ Vetitë dhe dinamika e troposferës (ajrit). ➢ Parametrat kryesor meteorologjik të rëndësishëm për ndotjen e ajrit. ➢ Ndotësitë kryesor dhe rrugët e bartjes së tyre në troposferë, emitimi dhe imitimi. ➢ Transformimi dhe transporti i substancave ndotëse në ajër. ➢ Përdorimi i pajisjeve-teknologjive konkrete në reduktimin-eliminimin e substancave ndotëse në ajër.
QËLLIMI	Qëllimi kryesor i kursit është t'u ofrojë studentëve një sfond shkencor dhe teknik në monitorimin e ndotjes së ajrit, teknologjitë e kontrollit të ndotjes dhe menaxhimin e mjedisit. Ky kurs fokusohet veçanërisht në proceset industriale dhe impiantet. Studentët do të njihen gjithashtu me kuadrin legjislativ evropian për cilësinë e ajrit dhe me konventat ndërkombëtare.

ARRITSHMËRIA

- Pas përfundimit të kursit të lëndës, studentët do të jenë në gjendje të:
  a. Përshkruajnë çështjet aktuale të ndotjes së ajrit në të gjitha shkallët (nga lokale në globale)
  b. Listojnë ndotësit kryesorë të ajrit dhe efektet e tyre në shëndet, mjedis, bimësi dhe materiale
  c. Diskutojnë disa lloje të problemeve të ndotjes së ajrit dhe kiminë dhe fizikën duke prekur ato
  d. Zgjidhin probleme të thjeshta që lidhen me shpërndarjen dhe modelimin e cilësisë së ajrit
  e. Zgjedhin metodat për kontrollin dhe parandalimin e ndotjes së ajrit për të përmbushur dëshirën nevojave brenda kufizimeve realiste si ekonomike, mjedisore, sociale, politike, etike, shëndetsore, prodhueshmërisë dhe qëndrueshmërisë
  f. Analizojnë operacionet e ndryshme të njësisë dhe proceset e njësive të përdorura në trajtimin e ajrit
  g. Vlerësojnë kriteret e projektimit të procesit për teknologji të ndryshme të trajtimit të ajrit dhe kryejnë llogaritjet bazë

PROGRAMI

Javët	Tema
Java - I	Prezantimi i syllabusit të lëndës – Hyrje
Java - II	Përbërja kimike e atmosferës, Shtresat e Atmosferës, Burimet e ndotjes së atmosferës.
Java - III	Kualiteti i ajrit, Ndotësit primar dhe sekondar, Grimcat e suspenduara
Java - IV	Reaksionet e ndotësve të ajrit në atmosferë
Java - V	Pasojat e ndotjes së ajrit (Shiu acid, Smogu kimik dhe fotokimik, Hollimi i shtresës së ozonit, Gazet serrë dhe ngrohja globale)
Java - VI	Marrëveshjet Ndërkombëtare mbi trajtimin e ajrit (Konventa mbi ndotjen Ndërkufitare të ajrit, Konventa e Kombeve të Bashkuara mbi ndryshimet klimatike-UNFCCC, Protokolli i Kyotos) Legjislacioni mjedisor Kombëtare mbi trajtimin e ajrit (Ligji mbi ndotjen e ajrit, Strategjia e Ajrit)
Java - VII	Efektet e ndotjes së ajrit (efektet në materiale, në bimësi, në shëndet)
Java - VIII	*Testi 1*
Java - IX	Proceset dhe paisjet e kontrollit të emitimit te grimcave Ciklonet
Java - X	Skruberët
Java - XI	Filtrat me thasë
Java - XII	Precipitatorët elektrostatik
Java - XIII	Sedimentuesit gravitacional
Java - XIV	Teknikat e kontrollit të ndotësve të gaztë Absorbimi, Adsorbimi, Oksidimi, Kondenzimi
Java - XV	*Testi 2*

LITERATURA	Literatura themelore: 1. Daniel Vallero, *Fundamentals of Air Pollution*, Elsevier, 2014 2. I. Lagzi, R.Meszaros, G. Gelybo and A. Leelossy, *Atmospheric Chemistry*, 2013. 3. U.S. Environmental Protection Agency Office, *Quality Assurance Handbook for Air Pollution Measurement Systems* Volume II, 2017 4. Sllajdet e ligjëratave Literatura plotësuese: 5. M. Pence, Handbook of Air pollution Control Systems and Devices, 2012.
METODOLOGJIA E MËSIMDHËNJËS	Leksion i avancuar, diskutim, punë në grupe, punë individuale, metoda ndërvepruese (interaktive) të mësimdhënies.

Kontributi në ngarkesën e studentit (gjë që duhet të korrespondoj me rezultatet e të nxënit të studentit – 1 ECTS kredi = 25 orë)

Aktiviteti	Orë	Ditë/javë	Gjithsej
Ligjërata	2	15	30
Ushtrime	2	15	30
Konsultime me mësimdhënësin/asistenten	1	3	3
Kolokiume /seminare	2	1	2
Detyra të pavarura	1	7	7
Koha e studimit vetanak të studentit (në bibliotekë ose në shtëpi)	2	15	30
Përgatitja përfundimtare për provim	5	9	45
Koha e kaluar në vlerësim (teste, kuiz, provim final)	1	2	2
Projektet, prezantimet, etj	1	1	1
Totali			**150 orë= 6 ECTS**

VLERËSIMI	**Metodat e vlerësimit** Vlerësimi në % Testi i –I-rë, me shkrim ..... 25% Testi i – II-të, me shkrim ..... 25% ose Provimi teorik ..... 50% Pjesëmarrja në ligjërata dhe ushtrime ..... 20% Punimi seminarik.....10% Povimi me shkrim .....20% **Shkallët e notave** : 50-më pak – nota 5 (pesë) 51-60 % - nota 6 (gjashtë) 61-70 % - nota 7 (shtatë) 71-80 % - nota 8 (tetë) 81-90 % - nota (nëntë) 91-100 % - nota (dhjetë)
RREGULLAT E MIRËSJELLJES DHE POLITIKAT AKADEMIKE	- Punimet seminarike duhet të jenë punime të secilit student duke respektuar rregullat drejtshkrimore dhe stili APA - Dënohet çdo forma e kopjimit dhe falsifikimit - Studenti që ka 3 mungesa pa arsye, konsiderohet se humb të drejtën për t'iu shtruar provimit - Secili studentë ka të drejtë të bëjë pyetje e komente sa herë që i jepet fjala - Asnjëri nuk ka të drejtë t'i nderhyjë tjetrit kur e ka fjalën - Lejohet zhurma e punës kur studentët punojnë në grupe - Nuk lejohet prishja e qetësisë kur ligjerohet nga mesimdhënësi apo prezantohet puna e studentëve - Nuk lejohet ardhja me vonesë apo dalja pa ndonje arsye të qëndrueshme - Nuk lejohen telefonat celularë përveq atëherë kur lejon mësimëdhënësi për qëllime mësimi

Mitrovicë **Bartës/e i/e lëndës:**

Prof. Asoc. Dr. Flora FERATI

_____/_____/____ _____

(Emër Mbiemër)

_____

(Nënshkrimi)